

VENDIM
Nr. 180, datë 4.4.2019

**PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZË SË VLERËSUAR
TË VITIT 2017, PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, paragrafi i dytë, dhe 59, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit, të jetë 3,7 për qind.

2. Për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve, me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të miratuar me vendimin nr. 571, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", shtohen edhe me koeficientin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Në vitin 2019, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekësh, e përcaktuar në vendimin nr. 809, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 114 670 (njëqind e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit nr. 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, dhe përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bazuar në vendimin nr. 571, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", dhe në këtë vendim, harton e shpall tabelën e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar për periudhën deri në vitin 1994 dhe për vitet në vazhdim, deri në vitin 2019, dhe ngarkohet për zbatimin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama